

Në përputhje me nenin 26 paragrafi 1 pika c të ligjit “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (“Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës numër 103/09) dhe nenin 61 paragrafi 2 të ligjit “Për administratën publike” (“Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës numër 32/2 dhe 102/9), Ministri i Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të Bosnjë-Hercegovinës miraton:

UDHËZIMIN

PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË PERSONAVE FIZIKË DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR TREGTINË E JASHTME TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE TË RËNDËSISË STRATEGJIKE PËR SIGURINË E BOSNJË-HERCEGOVINËS

Neni 1. (Objekti i udhëzimit)

Ky Udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e subjekteve juridike dhe personave fizikë për tregtinë e jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës, dhe dhënien e vendimit për regjistrimin në Regjistrin e operatorëve të tregtisë së jashtme (në vijim referuar si: Regjistri), ose vendimit për refuzimin e kërkesës, në përputhje me ligjin “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës (në vijim referuar si: Ligji).

Neni 2. (Përkufizimet)

Termtat e përdorura në këtë Udhëzim kanë të njëjtat kuptime si termtat e përdorura në ligj.

Neni 3. (Vendimi për regjistrimin në Regjistër)

- (1) Për kryerjen e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të specifikuar në listat e kontrollit nevojitet një vendim për regjistrimin në Regjistër.
- (2) Subjektet juridike mund të marrin vendimin për regjistrimin në Regjistër për kryerjen e tregtisë së jashtme të artikujve të përmendur në listat e kontrollit për një periudhë të gjatë ose të shkurtër kohore, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, të cilin e lëshon Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike (në vijim referuar si: Ministria) me kërkesë të subjektit juridik.
- (3) Personat fizikë mund të marrin një vendim të përkohshëm për regjistrimin në Regjistër vetëm për kryerjen e tregtisë së jashtme të mallrave për nevoja personale nga Lista e mallrave për përdorim të veçantë, të cilin e lëshon Ministria me kërkesë të personit fizik.

Neni 4. (Kërkesa për dhënien e vendimit për regjistrimin në Regjistër)

- (1) Bashkë me kërkesën e subjektit juridik për lëshimin e vendimit për regjistrimin në Regjistër dorëzohen:
 - a) kopja e noterizuar e vendimit për regjistrimin në regjistrin e gjykatës ose ekstrakti nga ligji “Për organet shtetërore”;
 - b) lista e personave të autorizuar dhe e funksioneve të tyre, në veçanti emri i personit të autorizuar për tregtinë e jashtme, e certifikuar nga personi përgjegjës;

- c) vërtetimi për regjistrimin në regjistrin themeltar të tatimpaguesve të tatimit indirekt në bazë të regjistrimit të TVSH-së dhe për kryerjen e aktivitetit të tregtisë me jashtë;
 - d) dokumenti i lëshuar nga organi përgjegjës për kryerjen e detyrave nga aktivitetet e regjistruara dhe që lidhen me mallrat dhe shërbimet nga listat e kontrollit.
 - e) vërtetimi për pagesën e taksës prej 5,00 KM për depozitimin e kërkesës dhe prej 15,00 KM për lëshimin e vendimit për regjistrimin në Regjistër.
- (2) Bashkë me kërkesën e personit fizik për dhënien e vendimit të përkohshëm për regjistrimin në Regjistër dorëzohen:
- a) fotokopja e noterizuar e kartës së identitetit;
 - b) leja e organit kompetent për blerjen e mallrave për nevoja personale nga Lista e mallrave për përdorim të veçantë;
 - c) vërtetimi i pagesës së taksës prej 5,00 KM për depozitimin e kërkesës dhe prej 15,00 KM për dhënien e vendimit të përkohshëm për regjistrimin në Regjistër.

Neni 5.

(Dhënia e vendimit për regjistrimin në Regjistër)

- (1) Ministria u jep subjekteve juridikë vendimin për regjistrimin në Regjistër që përmendet në nenin 3 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi dhe personave fizikë vendimin për regjistrimin e përkohshëm në Regjistër që përmendet në nenin 3 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi.
- (2) Ministria jep vendimin për regjistrimin në Regjistër brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit sipas rregullave të kërkesës së plotë, ose brenda 60 ditëve nëse Ministria ka kërkuar informacione ose verifikime shtesë nga organet e tjera të administratës shtetërore.

Neni 6

(Refuzimi i kërkesës për dhënien e vendimit për regjistrimin në Regjistër)

Ministria e refuzon kërkesën për dhënien e vendimit për regjistrimin në Regjistër në rastet e mëposhtme:

- a) nëse të dhënat në kërkesë janë të paplota ose të pasakta, ose nëse kërkesa nuk shoqërohet nga dokumentet e përmendura në nenin 4 paragrafi 1 ose nenin 4 paragrafi 2 të këtij Udhëzimi;
- b) nëse subjekti juridik ose personi fizik ka shkelur dispozitat ligjore gjatë aktiviteteve të mëparshme që lidhen me tregtinë e mallrave nga listat e kontrollit.

Neni 7.

(Shtojcat)

Formularët e kërkesës për lëshimin e vendimeve për regjistrim në Regjistrin e subjekteve të tregtisë me jashtë, vendimeve për regjistrimin e përkohshëm në regjistrin e personave të tregtisë me jashtë dhe të vendimit për regjistrimin në Regjistrin e personave të tregtisë me jashtë janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi.

Neni 8.

(Shfuqizimi)

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi për procedurën e regjistrimit të subjekteve juridike dhe personave fizikë për tregtinë e armëve dhe pajisjeve ushtarake ("Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 14/3).

Neni 9
(Hyrja në fuqi)

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit të tij në “Fletoren zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”.

Numër: 07-1-02-784/10

2.3.2010

Sarajevë

MINISTRI
Mladen Zirojević

Botuar në “Fletoren zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës” numër 19/10 të datës 15.3.2010